



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 83

Tiranë – E enjte, 20 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 12.4.2017	Për miratimin e shtesës së marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për dhënien e asistencës financiare për projektin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike (PTDP)..... 4941
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 317, datë 12.4.2017	Për emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet..... 4946
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 318, datë 12.4.2017	Për rishpërndarjen, nga Ministria e Zhvillimit Urban në disa njësi të qeverisjes qendrore, të fondit të financimit për projektet e reja, thirrja I, për vitin 2017, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I, miratuar me vendimin nr. 12, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve..... 4946
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 12.4.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 828, datë 23.11.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për kalimin e së drejtës së pronësisë, pa pagesë, mbi truallin dhe objektet e ndërtuara për familjet e shpërngulura nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës”..... 4947
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 12.4.2017	Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion/partneritet publik privat të kompletimit dhe ndërtimit të Rrugës së Arbrit..... 4947
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 323, datë 12.4.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të arkëtimeve dhe uljen e nivelit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar..... 4948
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 12.4.2017	Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Tiranës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth.. 4948

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 12.4.2017	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane” truall, të pasurisë me numrin 31/4, zona kadastrale 2255, bashkia Shijak, të pasurive me numrat 106/9, 106/12 e 106/13, me sipërfaqe 10 500 m ² , të sipërfaqes prej 705 m ² nga pasuria me numrin 106/4, zona kadastrale 3385, fshati Shkallnur, njësia administrative Rrashbull, bashkia Durrës.....	4953
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 12.4.2017	Për një shtesë në vendimin nr. 640, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e sporteleve të fondit të sigurimit të detyrueshëm në administrim të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”.....	4954
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 328, datë 12.4.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i qendrës së qytetit Koplik”.....	4954
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 12.4.2017	Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik.....	4957
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 13, datë 13.4.2017	Për një shtesë në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4958
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 7113/11, datë 12.4.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi” rruga automobilistike “Pasho Hysi” në Bashkinë e Skraparit.....	4959
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 7114/9, datë 12.4.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rivitalizimi i rrugës “Dëshmorët”, Çorovodë” në bashkinë e Skraparit.....	4959
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 2305, datë 13.4.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Mbrotja lumore e qytetit nga përmbytja, erozioni i lumit Osum dhe rehabilitimi urban i kësaj zone”.....	4960
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Evis Ahmetli.....	4961
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Meri Musabelliu.....	4961

**VENDIM****Nr. 315, datë 12.4.2017****PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË
MARRËVESHJES, NDËRMJET
QEVERISË SË KONFEDERATËS
ZVICERANE DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËR
DHËNIEN E ASISTENCËS
FINANCIARE PËR PROJEKTIN E
TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE (PTDP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e shtesës së marrëveshjes, ndërmjet qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për dhënie e asistencës financiare për projektin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike (PTDP), të miratuar me vendimin nr. 140, datë 4.3.1996, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Shtesë**e**

**Marrëveshjes ndërmjet
Qeverisë së Republikës së Shqipërisë
dhe
Qeverisë së Zvicrës**

për

**Dhënie e Asistencës Financiare për
Projektin e Transmetimit dhe Shpërndarjes
së
Energjisë Elektrike (PTDP)**

Në përputhje me nenet 3.7 dhe 4.2 të Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Këshillit Federal të Zvicrës dhe Këshillit të Ministrave të

Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar, të lidhur dhe të nënshkruar në Tiranë më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar nga Parlamenti i Shqipërisë me ligjin nr.9801 të datës 13 shtator 2007 dhe në përputhje me Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Zvicrës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Dhënie e Asistencës Financiare për Projektin e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (PTDP), të nënshkruar më 9 dhjetor 1996, duke përfshirë Zgjatjen e Marrëveshjes, të nënshkruar më 30 prill 2002, dhe Shtyrjen e Marrëveshjes, të nënshkruar më 15 nëntor 2004, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1**Pagesat në Fondin Kundër Parti**

Në fund të dhjetorit të vitit 2009 Qeveria Shqiptare ka hapur një llogari të veçantë (Nr. 2117259L) në Bankën e Shqipërisë në Tiranë me emërtimin “Fondi Kundër Parti (CPF) për Projektet me Fond Social Shqipëri-Zvicër” për pagesat që duhet të kryhen në valutën vendase nga përfituesi, në këtë rast, Korporata Elektroenergetike Shqiptare (KESH), në përputhje me marrëveshjen e PTDP-së.

Vlera e përgjithshme e kontributit të parimbursueshëm zviceran për Projektin e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë është 13'950'000 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë mijë Franga Zvicerane) CHF. Një program i detajuar shlyerjeje, i përfshirë si shtojcë në këtë Shtesë, parashikon se KESH ka kryer shlyerjen e parë në vitin 2009 dhe vijon me dy pagesa vjetore, një në çdo gjashtë muaj, deri në vitin 2024, sipas vlerave të parashikuara në shtojcë.

Neni 2**Menaxhimi i Fondit Kundër Parti**

Fondi Kundër Parti menaxhohet nga një Komision i përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI), Ministrisë së Financave (MF), Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe KESH-it. Komisioni drejtohet nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë së Shqipërisë ose nga zëvendësi i tij.



Neni 3

Përgjegjësitë e MEI-t dhe MF-së

3.1 MEI do të lëshojë një urdhër për krijimin e Komisionit dhe do të përcaktojë rregullat, procedurat dhe parimet e qeverisjes së Komisionit.

3.2 MEI i komunikon Ambasadës së Zvicrës në Tiranë emrat e anëtarëve të Komisionit.

3.3 MEI do të lëshojë një urdhër për rregullat dhe procedurat për aplikimin, përzgjedhjen, zbatimin, raportimin, monitorimin, auditimin dhe vlerësimin e projekteve. MEI do t'ia dërgojë projekt urdhrin përkatës Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri për miratim.

3.4 MEI do të caktojë një person kontakti të Komisionit për Ambasadën Zvicerane në Tiranë dhe do të informojë Ambasadën sipas rrethanave.

3.5 MEI dorëzon propozimet e projekteve të përfunduara të përzgjedhura nga Komisioni që duhet të financohen nëpërmjet CPF-së në Ambasadën Zvicerane në Tiranë për miratim. Propozimet e dorëzuara japin informacion mbi qëllimet, modalitetet e zbatimit, buxhetin, qeverisjen, organizimin, procedurat e raportimit dhe monitorimit të projektit.

3.6 MEI mundëson buxhetin e nevojshëm për të rimbursuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për ata kontraktues që kanë zbatuar projekte të financuara nga ky CPF.

3.7 MEI do t'i paraqesë Ambasadës së Zvicrës në Tiranë Raportin Vjetor të CPF-së me informacione mbi ecurinë e projekteve në zbatim të financuar përmes CPF-së dhe bilancit të CPF-së. Raporti Vjetor i CPF-së përfshin raportin vjetor të auditimit financiar.

3.8 MF monitoron përmbushjen në kohë të detyrimeve që KESH ka për shlyerje ndaj CPF-së.

Neni 4

Përdorimi i Fondit Kundër Parti CPF

4.1 Komisioni do të vlerësojë dhe miratojë propozimet për projekte në sektorin e energjisë, veçanërisht në fushat e Efikasitetit të Energjisë dhe Energjive të Rinovueshme, përfshirë përbërësit socialë. Projektet e propozuara, ndër të tjera, sigurojnë shërbime publike gjithëpërfshirëse dhe cilësore, integrojnë grupet e cënueshme, mbështesin barazinë gjinore dhe zvogëlojnë pabarazitë rajonale.

4.2 Komisioni miraton vetëm projekte për të cilat nuk mundësohen forma alternative financimi nga sektori privat (parimi i shtesës).

4.3 Ambasada e Zvicrës në Tiranë do të japë miratimin e saj për projektet e përzgjedhura nga Komisioni, bazuar në kriteret e mëposhtme: Përbërësi social i projektit, ndikimi në zhvillim, përputhja me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 të Shqipërisë dhe parimi i shtesës (Neni 4.2).

4.4 Të ardhurat e CPF-së do të mundësohen për grante për blerjen e pajisjeve, pjesëve të këmbimit, punimeve vendore, produkteve të konsumueshme dhe shërbimeve.

4.5 CPF-ja financohet vetëm kostot e lidhura drejtpërdrejt me qëllimet e projekteve të miratuara. Asnjë e ardhur e CPF-së nuk përdoret për të paguar detyrime apo tatime (tarifa doganore, tarifa importi, taksa, tarifa të çdo lloji) të përcaktuara sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë apo organeve shtetërore vartëse.

4.6 Një vlerë prej deri në 5% të të ardhurave të CPF-së mund të vihet në dispozicion për të mbuluar shpenzimet administrative të kryera prej Komisionit dhe njësive të tjera bashkërenduese të autorizuar për zbatimin e projektit, si dhe për veprimtaritë e nevojshme të shqyrtimit, monitorimit, vlerësimit dhe auditimit në kuadrin e projekteve të financuara nga CPF-ja.

4.7 Anëtarëve të Komisionit nuk u lind e drejta e përfitimit të shpërblimit nga CPF-ja.

Neni 5

Klauzola Antikorrupsion

Palët kontraktuese ndajnë një shqetësim të përbashkët në lidhje me luftën kundër korrupsionit që rrezikon qeverisjen e mirë dhe përdorimin e duhur të burimeve të nevojshme për zhvillim, dhe gjithashtu rrezikon konkurrencën e drejtë dhe të lirë bazuar në çmim dhe cilësi. Për këtë arsye, Palët deklarojnë angazhimin e tyre për të bashkuar përpjekjet në luftën kundër korrupsionit dhe në veçanti deklarojnë se të gjitha ofertat, dhuratat, pagesat, shpërblimet apo përfitimet e çfarëdo lloji të ofruara nga kushdo, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, me qëllim dhënien e një mandati apo lidhjen e një kontrate në kuadrin e kësaj Shtese ose gjatë zbatimit të saj, do të konsiderohen si një veprim i jashtëligjshëm ose praktikë korruptive. Të gjitha veprimet e këtij lloji përbëjnë baza të



mjaftueshme për të justifikuar shfuqizimin e kësaj Shtese, prokurimin ose kontratën e lidhur përkatëse, ose për marrjen e të gjitha masave të tjera korrigjuese të parashikuara nga legjislacioni përkatës.

Neni 6

Kriteret e Auditimit

6.1 Çdo vit, një auditues i pavarur shqiptar, i caktuar nga MF-ja, shqyrton veprimtaritë e CPF-së dhe auditon pasqyrat e tij financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare. Rezultatet e auditimit përmbledhen në raportin vjetor të auditimit financiar dhe i bashkëlidhen Raportit Vjetor të CPF-së.

6.2 Kostot e auditimeve financiare vjetore të rregullta mbulohen nga CPF-ja.

6.3 Në rastet kur raporti i auditimit financiar identifikon parregullsi që nuk janë të pranueshme për Komisionin, akordimi i fondeve për projekte të mëtejshme mund të pezullohet nga Komisioni deri në korrigjimin e parregullsive, ose mund të ndërpritet nëse parregullsitë nuk mund të korrigjohen. Në të dyja rastet, Ambasada e Zvicrës në Tiranë informohet menjëherë.

Neni 7

Dispozitat Parashikuese

Dispozitat e mëposhtme parashikuese janë rënë dakord nga Palët Kontraktuese:

7.1 Në rast se KESH nuk i përmbush detyrimet e tij vjetore për shlyerje, MF ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për zbatimin në përputhje të plotë me marrëveshjen e PTDP-së.

7.2 Në rast se KESH shpall faliment, MF ndërmerr të gjitha masat për të përfituar të drejtat e kreditorit të klasit të parë sipas ligjit shqiptar për procedurat e falimentit.

7.3 Në rast se KESH ndahet në disa ndërmarrje në kuadër të skemës së Asistencës Financiare, MF zbaton detyrimet e shlyerjes që i kalohen njërive të reja në përputhje me pjesën e asistencës financiare të projektit që përfitojnë në kuadrin e ndarjes së sendeve pasurore/aseteve.

7.4 Në rast se në kuadër të skemës së Asistencës Financiare KESH privatizohet pjesërisht ose plotësisht, MF duhet të informojë Ambasadën e Zvicrës në Tiranë mbi aspektet teknike dhe financiare të procedurës së privatizimit dhe përdorimin e të ardhurave nga privatizimi nga Qeveria. Ministria e Energjisë dhe

Industriisë merr masa që detyrimet në kuadrin e marrëveshjes së PTDP të ndërmerren plotësisht nga shoqëria e re private.

Neni 8

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet mbi interpretimin apo zbatimin e dispozitave të Shtesës në fjalë zgjidhen me anë të bisedimeve diplomatike.

Neni 9

Zbatimi

9.1 Kjo Shtesë e Marrëveshjes hyn në fuqi pas njoftimit nga pala shqiptare se procedurat e brendshme ligjore vendase, të cilat mundësojnë hyrjen në fuqi të kësaj Shtese, kanë përfunduar.

9.2 Ndryshimet e Shtesës në fjalë bëhen vetëm me marrëveshje të ndërsjellë të arritur përmes shkëmbimit të letrave nga përfaqësuesit e autorizuar nga Palët Kontraktuese.

9.3 Me kërkesë të secilës Palë Kontraktuese, palët shqyrtojnë bashkërisht përmbajtjen dhe zbatimin e Shtesës dhe në kuadër të vërejtjeve të bëra dhe mësimave të nxjerra, ato ndërmarrin hapa të duhur për të garantuar arritjen e të gjitha qëllimeve të dokumentit.

Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Zvicrës për Dhënien e Asistencës Financiare për Projektin e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (PTDP), të nënshkruar më 9 dhjetor 1996, duke përfshirë Zgjatjen e Marrëveshjes, të nënshkruar më 30 prill 2002 dhe Shtyrjen e Marrëveshjes, të nënshkruar më 15 nëntor 2004, nuk ndryshojnë.

Hartuar në më, në dy kopje në gjuhën angleze dhe dy origjinale në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Konfederatën Zvicerane

.....
Ambasada e Zvicrës në Shqipëri
Sh.T. Christoph Graf
Ambasador

Për Këshillin e Ministrave të
Republikës së Shqipërisë

.....
Ministria e Financave
Sh.T. Arben Ahmetaj
Ministër



PERKTHIM ZYRTAR TRADUCTION OFFICIELLE OFFICIAL TRANSLATION

Një program i Detajuar Shlyerjeje në Fondin Kundër Parti për Projektin e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (PTDP)

Sipas Dokumentit	Akorduar		Shlyerje nga KESH në Fondin Kundër Parti (CPF) për Fondin Social Shqiptaro-Zviceran (Banka e Shqipërisë 2117259L)	
	Data	Shuma në Franga Zvicerane [CHF]	Data	Franga Zvicerane [CHF]
Franga Zvicerane [CHF]				
Marrëveshja e PTDP-së /				
KESH	dhjetor 1996	13.950.000,00	2009-12-30	465.000
Marrëveshja e PTDP-së / ndryshimi i datës 15.11.2004				
KESH			2010-03-02	465.000
KESH			2010-08-06	465.000
KESH			2011-02-07	465.000
KESH			2011-07-27	465.000
KESH			2012-08-06	465.000
KESH			2012-08-06	465.000
KESH			2015-03-03	465.000
KESH			2015-03-03	465.000
KESH			2016-02-28	542.500
KESH			2016-08-31	542.500
KESH			2017-02-28	542.500
KESH			2017-08-31	542.500
KESH			2018-02-28	542.500
KESH			2018-08-31	542.500



KESH				2019-02-28	542.500
KESH				2019-08-31	542.500
KESH				2020-02-28	542.500
KESH				2020-08-31	542.500
KESH				2021-02-28	542.500
KESH				2021-08-31	542.500
KESH				2022-02-28	542.500
KESH				2022-08-31	542.500
KESH				2023-02-28	542.500
KESH				2023-08-31	542.500
KESH				2024-02-28	542.500
KESH				2024-08-31	542.500
Program i shlyerjeve totale					13.950.000

**VENDIM****Nr. 317, datë 12.4.2017****PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË
KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E
MASAVE PËR IMPORTET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3, të nenit 4, të ligjit nr. 9790, datë 19.7.2007, “Për masat mbrojtëse në importe”, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9796, datë 23.7.2007, “Për masat antidumping dhe kundërbalancuese”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet, si më poshtë vijon:

- Znj. Milva Ekonomi, ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- Z. Ardian Maçi, drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

- Z. Sajmir Laçe, drejtor në Ministrinë e Financave;

- Z. Flamur Laze, drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;

- Znj. Silvana Leskaj, përgjegjëse sektori në Ministrinë e Punëve të Jashtme;

- Znj. Ines Muçostepa, kryetar i Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë;

- Znj. Mirela Meko, zëvendësdyrëtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Anëtarët e komisionit janë, kryesisht, juristë dhe/ose ekonomistë.

3. Vendimi nr. 429, datë 8.4.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 318, datë 12.4.2017****PËR RISHPËRNDARJEN, NGA
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
NË DISA NJËSI TË QEVERISJES
QENDRORE, TË FONDIT TË
FINANCIMIT PËR PROJEKTET E
REJA, THIRRJA I, PËR VITIN 2017, TË
GRANTIT “INFRASTRUKTURA
VENDORE DHE RAJONALE”,
PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË
INFRASTRUKTURËS VENDORE DHE
RAJONALE, SHTYLLA I, MIRATUAR
ME VENDIMIN NR. 12, DATË 21.3.2017,
TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2017, për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, rishpërndahen në disa institucione qendrore, për financimin e projekteve të reja, të miratuara me vendimin nr.12, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projektet e reja, thirrja I, për vitin 2017, të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, shtylla I”, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 2, Agjencia për Zhvillimin Rajonal 3 dhe Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



Tabela nr.1 Rishpërndarja e fondeve buxhetore për projektet e reja të FZHR, për njësitë qendrore

ne leke										
EQ	Gr	Kodi inst.	Emertimi I Institucionit	Kap.	Programi	Llog. ekon.	Kodi i Thesarit	Kodi i projektit	Shuma	Emertimi i projektit te investimit
PAKËSOHET										
001	94	1094001	Aparati i MZHTJ	01	08210	23:0000	3535	M940115	99,719,177	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
Totali i pakësimeve									99,719,177	
SHTOHET										
01	87	1087023	AZHR 2	01	01150	2310000	3535	Kod I ri	33,285,796	Përmirësimi i transportit dhe infrastrukturës ndërtimtare Qaf Shitarë (Bashkia Krujë) - Burrel (Bashkia Mat), me qëllim promovimin e atraksioneve turistike të Parkut Kombëtar të Qafshitarës. (Loti 2.1) (infrastrukturë rrugore me interes të veçantë zhvillimi)
01	87	1087024	AZHR 3	01	01150	2310000	1515	Kod I ri	37,033,381	Rigjallërimi i vlerave historike, kulturore e turistike të Zonës së Zhvillimit Rajonal 3, Korce, Elbasan (3 kile)
01	87	1087021	AZHR	01	01150	2310000	3535	Kod I ri	29,400,000	Qendër multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja
Totali i shtesave									99,719,177	

VENDIM

Nr. 320, datë 12.4.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 828, DATË 23.11.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE TË AFATEVE PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË, PA PAGESË, MBI TRUALLIN DHE OBJEKTET E NDËRTUARA PËR FAMILJET E SHPËRNGULURA NGA NDËRTIMI I UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe nenit 39/1, pika 5/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “Për programet sociale të strehimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 828, datë 23.11.2016, të Këshillit të Ministrave, fjalë e dytë e pikës 7, ndryshohet, si më poshtë:

“Sipërfaqja e truallit që përfitohet, pa pagesë, është sipas evidentimit faktik në terren, deri në masën e 500 metrave katrorë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI

Niko Peleshi**VENDIM**

Nr. 321, datë 12.4.2017

PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË KOMPLETIMIT DHE NDËRTIMIT TË RRUGËS SË ARBRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 25, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar dhe në vijim të pikave 1 e 2, të nenit 15, “Dhënia e bonusit”, të rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale, të miratuara me vendimin nr. 634, datë 1.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 10 (dhjetë) % të pikëve, që i jepet shoqërisë “Gjoka konstrukcion”, sh.a., për rezultatin teknik dhe financiar të propozimit të pakërkuar, të paraqitur për procedurën e koncesionit/ partneritetit



publik privat për kompletimin dhe ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

2. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 323, datë 12.4.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1086, DATË 14.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË ARKËTIMEVE DHE ULJEN E NIVELIT TË HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 6, të vendimit nr. 1086, datë 14.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... deri më 30 qershor 2017...”, zëvendësohen me “... deri më 31 dhjetor 2017...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 325, datë 12.4.2017

PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË TIRANËS DHE MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ E TË ZONËS SË MBROJTUR PËRRETH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 29, të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës, sipas hartës së zonifikimit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e rregullore për administrimin e Qendrës Historike të qytetit të Tiranës dhe zonës së mbrojtur përreth, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Vendimi nr. 180, datë 13.4.2000, i Këshillit të Ministrave, “Shpallja Ansambël Monumente Kulture i aksit kryesor dhe qendrës historike të qytetit të Tiranës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E QENDRËS HISTORIKE DHE ZONËS SË MBROJTUR TË QYTETIT TË TIRANËS

Neni 1

Qëllimi dhe objektivat

1. Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për administrimin e vlerave historike-kulturore të qendrës historike dhe zonës së mbrojtur në qytetin e Tiranës.

2. Objektivat kryesorë të kësaj rregulloreje janë:

a) Administrimi i qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës, sipas zonifikimit të paraqitur në hartën që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje si pjesë përbërëse e saj.

b) Mënyrat e bashkëpunimit me njësinë e qeverisjes vendore të qytetit të Tiranës.

Neni 2

Kjo rregullore është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, ligjin nr. 9386, “Kartën Shqiptare të Restaurimit”, miratuar me vendimin nr. 426, datë 13.7.2007, të Këshillit të Ministrave, marrëveshjeve dhe dokumenteve të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit kulturor, të ratifikuara sipas legjislacionit shqiptar.



Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje e qytetit të Tiranës përbëhet nga:

- a) Qendra historike në qytetin e Tiranës;
- b) Zona e mbrojtur.

2. Brenda kësaj zone përfshihen ansamble historike, sheshe publike, monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë.

3. Plani i përgjithshëm vendor i qytetit të Tiranës duhet të marrë parasysh kufijtë dhe kriteret e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur në qytetin e Tiranës.

Neni 4

Qendra historike dhe kufijtë e saj

1. Qendra historike në qytetin e Tiranës është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistike arkitekturore që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit të Tiranës dhe arrijtjet në arkitekturë dhe urbanistikë.

2. Kufijtë e qendrës historike paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Tiranës, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e kësaj rregulloreje.

Neni 5

Zona e mbrojtur dhe kufijtë e saj

1. Zona e mbrojtur ruan vlera historiko-kulturore, me të cilat plotësohen dhe pasurohen vlerat e qendrës historike duke krijuar një kalim gradual drejt pjesëve të tjera të qytetit.

2. Kufijtë e zonës së mbrojtur paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Tiranës, e cila është pjesë përbërëse e pandarë e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Ndarja e monumenteve sipas kategorive

Monumentet e kulturës në qytetin e Tiranës, sipas vlerave të tyre historiko - kulturore ndahen në dy kategori:

1. Monumentet e kategorisë së parë, të cilët ruhen në përbërësit kompozicionalë, arkitekturorë, teknikë dhe të materialeve të ndërtimit.

2. Monumente të kategorisë së dytë, janë ndërtime me vlera historiko-kulturore dhe marrin

pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

Neni 7

Ndërhyrjet në Qendrën Historike

Ndërhyrjet restauruese në qendrën historike do të kenë si qëllim mbrojtjen e vlerave arkitektonike të trashëgimisë kulturore. Për të realizuar këtë qëllim në qendrën historike kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistike-arkitekturore të qendrës historike në qytetin e Tiranës, brenda kësaj zone mund të kryhen këto ndërhyrje:

1. Ndërhyrje sistematike konservuese, restauruese dhe të mirëmbajtjes, si dhe në monumentet e të dy kategorive bazuar në kriteret për konservimin dhe restaurimin.

2. Ndërhyrjet restauruese që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistike-arkitekturore, rritet rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale.

3. Ndërhyrjet bazuar në studime për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të qendrës historike, mund të kryhen në :

a) objektet, ku kryhen punime konservuese dhe restauruese;

b) objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre;

c) zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese;

d) hapësirat publike dhe sipërfaqet e gjelbëruara.

4. Ritrajtimet e përmendura në pikën 3 duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të qendrës historike, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

5. Rikonstrukcion mbi strukturat ekzistuese mund të kryhet: në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimin, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.



6. Ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistik-arkitektonik.

Neni 8

Ndërhyrjet në monumente

1. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së parë ruajnë kompozimin dhe teknikat origjinale si në brendësi, ashtu edhe në pamjet e jashtme. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

2. Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së dytë ruajnë volumin fillestar dhe formulimin e pamjes së jashtme, ndërsa në brendësi mund të bëhen ndryshime, duke zbatuar kompozime sipas kërkesave të kohës dhe teknikat e sotme.

Neni 9

Ndërhyrjet në zonën e mbrojtur

1. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit.

2. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve, përveç rasteve kur për to ka studime të veçanta, nuk duhet të kalojë lartësinë e objektit më të lartë të qendrës historike.

3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës së qendrës historike.

4. Ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistik-arkitektonik.

5. Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo për përmirësimin ose realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika në përputhje me arkitekturën e ansamblit muze.

6. Ndërhyrje të mobilimit urban me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve në harmoni me arkitekturën e objekteve që ndodhen brenda qendrës historike.

Faqe| 4950

7. Ndërhyrje për modifikimin e gjurmës rrugore, e lidhur me nevojat për funksionim dhe përdorim sa më të mirë të zonës brenda së cilës rruga ndodhet.

8. Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyhet, shtrihet në disa zona, ndërhyrja i nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë.

Neni 10

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në qendrën historike, zonën e mbrojtur dhe monumente të veçanta

1. Projektet e restaurimit në qendrën historike dhe restaurimi i monumenteve të kulturës hartohen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjekte të licencuara për këtë qëllim. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR).

2. Zbatimi i punimeve të mësipërme në territorin e qendrës historike kryhet nga DRKK-Durrës ose subjekte të licencuara për restaurim, mbikëqyrësi i punimeve dhe kolaudatori, caktohen nga IMK.

3. Studimet dhe projektet e rikonstruksioneve në territorin e qendrës historike hartohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës ose nga persona të licencuar në fushën e restaurimeve për këtë kategori projektesh.

Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

4. Studimet dhe projektet në territorin e qendrës historike për ndërhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore hartohen nga subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushat përkatëse, në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK), Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) Durrës ose persona të licencuar në fushën e restaurimeve. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

5. Studimet për rehabilitimin e imazhit të zonës së mbrojtur hartohen nga Instituti i



Monumente të Kulturës (IMK), Drejtoria Rajonale të Kulturës Kombëtare (DRKK) Durrës, subjekte të licencuara në fushën e restaurimeve sipas rregullores së miratuar, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë. Projektet shqyrtohen në Këshillin Shkencor të IMK-së dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Restaurimit (KKR). Procedura e miratimit vazhdon sipas ligjit për planifikimin e territorit.

6. Projektet e ndërtimeve të reja, rikonstruksioneve të ndërtesave në zonën e mbrojtur hartohen nga projektues ose subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushën e ndërtimit. Procedura e miratimit sipas ligjit për planifikimin e territorit.

7. Zbatimi i punimeve të ndërtimeve të reja dhe të rikonstruksionit në zonën e mbrojtur kryhet nga subjekte ndërtimore që janë të licencuar për këtë kategori.

8. Studimet dhe projektet për ndërrhyrje në rrjetin rrugor, infrastrukturën nëntokësore në zonën e mbrojtur hartohen nga subjekte projektuese të licencuara në projektim për kategorinë e mësipërme për fushat përkatëse. Procedura e miratimit sipas ligjit për planifikimin e territorit.

Neni 11

Shfrytëzimi i monumenteve

Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar, apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos çenojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje.

Neni 12

Mbrojtja e monumenteve

Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me Institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritur në hapësirat e juridiksionit të tyre.

Plani i përgjithshëm vendor i bashkisë Tiranë merr parasysh vlerat e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur.

Neni 13

Trajtimi i rasteve të paparashikuara

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen nga Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore nëpërmjet institucioneve të specializuara.

Neni 14


Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 15

Dispozita të fundit

Kësaj rregulloreje i bashkëngjitet harta e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Tiranës.



**VENDIM****Nr. 326, datë 12.4.2017**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT NGA KATEGORIA E
RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË
“TOKË URBANE” TRUALL, TË
PASURISË ME NUMRIN 31/4, ZONA
KADASTRALE 2255, BASHKIA SHIJAK,
TË PASURIVE ME NUMRAT 106/9,
106/12 e 106/13, ME SIPËRFAQE 10 500 M²,
TË SIPËRFAQES PREJ 705 M² NGA
PASURIA ME NUMRIN 106/4, ZONA
KADASTRALE 3385, FSHATI
SHKALLNUR, NJËSIA
ADMINISTRATIVE RRASHBULL,
BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numrin 31/4, zona kadastrale 2255, Bashkia Shijak, të pasurive me numrat 106/9, 106/12 e 106/13, me sipërfaqe prej 10 500 (dhjetë mijë e pesëqind) m², në zonën kadastrale 3385, fshati Shkallnur, njësia administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të një pjese të sipërfaqes së pasurisë me numrin kadastral 106/4, të

sipërfaqes 515 (pesëqind e pesëmbëdhjetë) m², ku do të zhvillohet struktura “Stallë”, dhe të sipërfaqes 190 (njëqind e nëntëdhjetë) m², ku do të zhvillohet struktura “Kantinë”, zona kadastrale 3385, fshati Shkallnur, njësia administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e kategorisë së resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 31/4, zona kadastrale 2255, Bashkia Shijak, të pasurive me numrat 106/9, 106/12 e 106/13, në zonën kadastrale 3385, fshati Shkallnur, njësia administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, dhe të pasurisë me numrin 106/4, zona kadastrale 3385, fshati Shkallnur, njësia administrative Rrashbull, Bashkia Durrës, vetëm për sipërfaqen ku do të zhvillohen strukturat “Stallë” dhe “Kantinë”, sipas hartës së miratuar me vendimin nr. 11, datë 28.7.2016, të Këshillit Kombëtar të Territorit.

4. Ngarkohet Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të realizojë ndarjen e pasurisë me numrim 106/4 në tri pasuri, sipas hartës së miratuar me vendimin nr.11, datë 28.7.2016, të Këshillit Kombëtar të Territorit.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Qarkut Durrës, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Lidhja nr.1

Nr. rendor	Numri pasurisë	Zona kadastrale	Sip në m ²	Vendndodhja	Bashkia	Lëshuar certifikata
1	31/4	2255	12900	Koxhas	Shijak	ZVRPP Durrës
2.	106/9	3385	2000	Shkallnur	Durrës	ZVRPP Durrës
3	106/12	3385	7000	Shkallnur	Durrës	ZVRPP Durrës
4	106/13	3385	1500	Shkallnur	Durrës	ZVRPP Durrës



Lidhja nr.2

Nr. rendor	Numri pasurisë	Zona kadastrale	Sip në m ²	Vendndodhja	Bashkia	Lëshuar kartela e pasurisë
1	106/4	3385	515	Shkallnur	Durrës	ZVRPP Durrës
	106/4	3385	190	Shkallnur	Durrës	

Parcela nr. 106/4, me sipërfaqe prej 58056 m², zona kadastrale 3385, volum 8, faqe 145, sipas kartelës së pasurisë së palujtshme të ZVRPP Durrës, shtet dhënë me qira për 99 vjet sipas kontratës 697 rep dhe 188/3 kol datë 27.12.2012, lidhur midis ish komunës Rrashbull dhe subjektit “Buna” sh.p.k. Kjo parcelë do të ndahet në tre pasuri, njëra me sipërfaqe 515m² ku do zhvillohet struktura “stallë”, tjetra me sipërfaqe 190 m² ku do zhvillohet struktura “Kantinë”, sipërfaqja prej 57351m² ngelet në zërin kadastral “arë”.

VENDIM**Nr. 327, datë 12.4.2017**

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.640, DATË 7.9.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr.13/2016, “Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 640, datë 7.9.2016, të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve “...në bashkitë Kavajë e Fier...”, shtohen fjalët “...Tiranë, Krujë dhe Gjirokastrë...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM**Nr. 328, datë 12.4.2017**

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “REHABILITIMI I QENDRËS SË QYTETIT KOPLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i qendrës së qytetit Koplik”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Malësi e Madhe.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 42 580 307 (dyzet e dy milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatë) lekësh.



4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 42 580 307 (dyzet e dy milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë e treqind e shtatë) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Malësi e Madhe.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe, të fillojnë procedurat për hedhjen e

gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 329, datë 12.4.2017****PËR STATUSIN DHE TRAJTIMIN E VEÇANTË TË PERSONELIT AKADEMIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personeli akademik gëzon status dhe trajtim të veçantë, që konsiston në liritë akademike, të drejtat ekonomiko-financiare, detyrimet e përgjegjësitë si dhe garancitë juridike e civile në zbatim të tyre.

2. Personeli akademik gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimtarisë së tij, në:

- a) mësimdhënie;
- b) punë kërkimore-shkencore;
- c) kontribut institucional;
- ç) kontribut profesional.

3. Liria akademike ushtrohet në kuadrin e përgjegjshmërisë pedagogjike e shkencore dhe nuk presupozon përjashtimin nga vlerësimi i performancës së personelit akademik.

Personeli akademik nuk mund të penalizohet për shkak të qëndrimeve të tij ndaj politikave të institucionit. Në të gjitha rastet, personeli akademik vepron brenda normave të etikës, në respekt të institucionit dhe kuadrin ligjor e nënligjor në fuqi.

4. Personeli akademik e humbet statusin kur përfundon/zgjidhet kontrata.

5. Anëtarët e personelit akademik nuk mund të penalizohen nga institucioni i arsimit të lartë për shkak të rezultateve të vlerësimit të punës së tyre kërkimore-shkencore, të kryera në përputhje me fushën përkatëse dhe misionin e institucionit të arsimit të lartë.

6. Në rast se anëtari i personelit akademik konstaton se i është cenuar liria akademike, dinjiteti profesional apo ka një qëndrim joetik ndaj tij, i drejtohet Këshillit të Etikës të IAL-së, për këtë çështje. Procedura e trajtimit të ankesave kryhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë. Vendimi i Këshillit të Etikës është gjithnjë i ankimeshëm në rrugë gjyqësore.

7. Anëtarët e personelit akademik të kategorive “Profesor” dhe “Lektorë”, punësohen në IAL nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të pacaktuar. Anëtarët e personelit akademik të kategorisë “Asistentë-lektorë”, punësohen në IAL nëpërmjet një kontrate me kohëzgjatje të caktuar. Të tria këto kategori mund të punësohen me kohë të plotë apo me kohë të pjesshme.

8. Personeli akademik nuk mund të largohet apo të zëvendësohet, pa miratimin e tij, gjatë kryerjes së punës kërkimore-shkencore në një projekt të ndjekur prej tij, përveç rasteve të shkeljeve të rënda të vërtetuara, të parashikuara në Kodin e Punës dhe aktet e brendshme të institucionit të arsimit të lartë.

9. Koha normale e punës së personelit akademik nuk mund të jetë më shumë se 1 536 orë në vit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik parashikohet në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Leja vjetore e personelit akademik është jo më pak se 40 ditë pune (56 ditë kalendarike). Në rast se kjo leje nuk konsumohet nga personeli akademik, si pasojë e nevojës së institucionit dhe me propozimin e drejtuesit të njësisë bazë dhe me miratimin e Bordit të Administrimit, jepet shpërblimi përkatës në të holla.

11. Personeli akademik, brenda kohës efektive të punës, mund të kryejë detyra akademike, shkencore ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, në përputhje me statutin dhe rregulloret e IAL-së.

12. Personeli akademik, për aktivitete që lidhen me drejtimit e punës së tij, sipas pikës 2, të këtij vendimi, ka të drejtën e përfitimit të një leje deri në dy javë, me miratim nga drejtuesi i njësisë kryesore, që informon, në çdo rast, rektorin. Për kohëzgjatje mbi dy javë, leja merret nga rektori. Në të gjitha rastet, kërkesat për leje duhet të jenë të dokumentuara dhe të justifikuara. Personeli akademik raporton përpara departamentit mbi aktivitetin e kryer gjatë lejes.

13. Personeli akademik mund të kryejë detyra të larta në administratën publike, vendase apo të huaj, për jo më shumë se 5 vjet, pa ndërprerje, duke ruajtur statusin e tij. Në funksion të ruajtjes së vendit të punës, sipas profilit akademik, nënshkruhet një marrëveshje e posaçme me rektorin e institucionit. Pas kësaj periudhe, anëtari i personelit akademik, me kërkesën e tij, rikthehet në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend të barasvlefshëm.



14. Personelit akademik i linden edhe këto të drejta të tjera:

a) Të përparojë në karrierën akademike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;

b) Të trajnohet, të kualifikohet në institucionet akademike e kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë vendit, sipas legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me profilin;

c) Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e IAL-së, duke kryer aktivitete zgjedhore në përputhje me statutin dhe rregulloret e tjera të IAL-së.

15. Personeli akademik ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) Të njohë, të respektojë, të zbatojë dhe të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

b) Të respektojë kohën në funksion të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, sipas orarit të punës dhe ta shfrytëzojë vetëm për kryerjen e detyrave. Koha e punës dhe e mësimdhënies përcaktohet nëpërmjet kontratës së punës;

c) Të rrisë aftësitë profesionale akademike dhe të marrë pjesë në veprimtari formuese për këtë qëllim;

ç) Të mos kërkojë ose pranojë asnjë përfitim pasuror, për kryerjen e detyrave akademike, me përjashtim të pagës dhe privilegjeve të tjera, të përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe aktet e brendshme të IAL-së;

d) Të mbajë përgjegjësi të plotë për veprimet e tij, gjatë kryerjes së detyrës si personel akademik në IAL dhe institucionin kërkimor shkencor;

dh) Të zbatojë etikën institucionale në respektim të imazhit të institucionit të arsimit të lartë dhe figurës profesionale.

e) Të zbatojë kodin e etikës në veshje e sjellje, gjatë kohës së ushtrimit të aktivitetit akademik.

16. Personeli akademik, me kohë të plotë apo të pjesshme, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion administrimi në institucionin e arsimit të lartë ku është punësuar, me përjashtim të zgjedhjes anëtar në Bordin e Administrimit.

17. Pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive përcaktohen nga Bordi i Administrimit, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik, por jo më shumë se kufijtë maksimalë të pagës për funksion/titull, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”.

18. Personeli akademik përfiton kompensim e rimbursim financiar, kur punon për aktivitetet e parashikuara në drejtimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi, në masën dhe sipas procedurave të përcaktuara nga Bordi i Administrimit dhe kuadrin ligjor në fuqi.

19. Personeli akademik mund të kërkojë leje, pa të drejtë page, për arsye shëndetësore apo familjare. Kohëzgjatja maksimale e të gjitha lejeve të papaguara, brenda një viti kalendarik, nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë.

20. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

UDHËZIM
Nr. 13, datë 13.4.2017

PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 24, DATË 2.9.2008, “PËR PROCEDURAT TATIMORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 10, pika 1 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Në fund të pikës 106.2.1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Për ankimet e paraqitura nga data 1 janar 2017 deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, data e marrjes së ankimit nga Drejtoria e Apelit Tatimor ose Komisioni është data në të cilën Drejtoria e Apelit Tatimor ka filluar ushtrimin e funksioneve pranë Ministrisë së Financave sipas legjislacionit në fuqi dhe ankimet janë marrë në dorëzim nga drejtori i Apelit Tatimor”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Ahmetaj

**KËRKESË****Nr. 7113/11, datë 12.4.2017****PËR SHPRONËSIM PËR
INTERES PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim i hapësirave përreth Pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi” rruga automobilistike “Pasho Hysi” në Bashkinë e Skraparit.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia e Skraparit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit

të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 653 703 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e tre) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I PUNËVE TË
BRENDSHME
Elona Gjebrea

Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit

“Rikualifikim i hapësirave përreth pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja “Pasho Hysi” rruga automobilistike “Pasho Hysi”

Bashkia Skrapar

Nr	Emri Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e ndërt/m2	Çmimi i ndërt./lek	Vlera e përgjithshme /lek	Lloji i dokumentit
1	Fatmira Tahir Xhizdari	1420	4/154	15	43 580	653 703	Vërtetim pronësie
	Totali					653 703	

KËRKESË**Nr. 7114/9, datë 12.4.2017****PËR SHPRONËSIM PËR
INTERES PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Rivitalizimi i rrugës Dëshmorët, Çorovodë” në bashkinë e Skraparit.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia e Skraparit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe

të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale shpronësimit është 932 552 (nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I PUNËVE TË
BRENDSHME
Elona Gjebrea



Lista e emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit
“Rivitalizimi i rrugës Dëshmorët, Çorovodë”

Bashkia Skrapar

Nr	Emri Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip e truallit/m2	Çmimi i truallit/lek	Sip. e ndërt./m2	Çmimi i ndërt./lek	Vlera e përgjithshme /lek	Lloji i dokumentit
1	Refije Qamil Cela	1420	11/122	18	1015	26	35,126,2	931 552	Vërtetim pronësie
	Totali							932 552	

KËRKESË

Nr. 2305, datë 13.4.2017

PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Mbrotja lumore e qytetit nga përmbytja, erozioni i Lumit Osum dhe rehabilitimi urban i kësaj zone”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia Ura Vajgurore.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në

dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të çmimeve të miratuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 4,604,849 (katër milionë e gjashtëqind e katër mijë e tetëqind e dyzet e nëntë) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I ZHVILLIMIT
URBAN
Alfred Dalipi

Lista e pronave që shpronësohen nga ndërtimi i mbrotjes lumore

Zona kadastrale	Emri i pronarit	Lloji i pasurisë				sipërfaqja që shpronësohet	Dokumenti i pronësisë		vlera e pronës			Personi okupues
		lloji	ndertese	truall	are		Lloji	viti	objekt	truall	t.hujq.	
3682	1896	I objektit	m2	m2	m2	shpronësohet						
	399/2	Agron Hasanbelliu				1687	642	certifikate	2014			130326
	399/3	Andrea Tomani				5781	1244	certifikate	2000			252532
1/403		Xhimi koragje				750	750	certifikate	2001			152250
1/451		Roland Këmbaci	shërbim	8.1	0	8.1	veriteti hipotek	2005	207269			
1/91-nd		Arshin dhe Drita Dymishi	banesë 1k	81.88	0	81.88	certifikate	2016	3203882			
1/404		viktor tafa				750	500	certifikate	2002			101500
1/402		xhimi koragje				630	630	certifikate	2001			127890
1/96		Luftar Hajdari				1300	1300	certifikate	2014			263960
1/115		Bashkëpronaret (sipas dok te pronësisë (9 bashkëpronare				26400	1653	certifikate				165380
		Shumat								3411151	1193698	
		Totali										
		total gjashtë										4604849



KËRKESË

Shtetasja Gentjana Ahmetli, e datëlindjes 3.1.1977, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë shpalljen të vdekur të shtetasit Evis Ahmetli, i datëlindjes 21.3.1974.

KËRKUESE
Gentjana Ahmetli

KËRKESË

Shtetasi Dorjan Musabellu, i datëlindjes 18.5.1981, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetases Meri Musabellu, e datëlindjes 1.7.1984.

KËRKUES
Dorjan Musabellu

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë